



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 28 Prot.

Tiranë, më datë 18.01.2023

VENDIM
Nr. 2, datë 18.01.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.01.2023:

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim Planin Paraprak të Gërmimeve Arkeologjike në kuadër të projektit “Hartimi i Planeve të Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike të Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake dhe të Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike A dhe B të Qytetit të Durrësit”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues shoqëria “Taulant” sh.p.k., zhvillues Ministria e Kulturës dhe AADF dhe hartues shoqëria “PlanArch” në bashkëpunim me subjektin “Taulant” sh.p.k. dhe Znj. Elida Miraj Zeqo (Lida Miraj);
2. Të hartohet Koncepti i Plotë i Gërmimeve Arkeologjike, për zonën e Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake, konform VKM nr. 220, datë 7.4.2021 “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”, i cili duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;
3. Koncepti i Gërmimeve Arkeologjike për zonën e Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake duhet të plotësohet me preventivin dhe grafikun e saktë të gërmimeve sipas fazave përkatëse dhe duhet të rakordohet me projektin “Prezantimi/ Interpretimi dhe Valorizimi i Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin, Banjave Romake dhe i Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit dhe Itinerari i Vizitorëve”;
4. Koncepti i Gërmimeve Arkeologjike në zonën e Amfiteatrit duhet të përfshijë në qëllimin e tij edhe hulumtimin për identifikimin e fasadës së Amfiteatrit;
5. Të hartohet Projekt Idea për ndërhyrjet restauruese për projektin “Hartimi i Planeve të Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike të Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake dhe të Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike A dhe B të Qytetit të Durrësit”, e cila duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI



SEKRETAR

Eugen KALLFANI